

Nr. 224 / 3 prot.

Urë Vajgurore, më 25.01.2024

VENDIM

Nr. 10 Datë 25.01.2024

“Mbi miratimin e raportit të vlerësimeve për vitet buxhetore 2021-2023, dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave, për tre vitet e ardhshme buxhetore 2024-2026”.

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 25.01.2024, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Tatim Taksave dhe e Menaxhimit të Aseteve, në mbështetje të Ligjit Nr 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Neni 55 të Ligjit Nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimit Nr 23 datë 22.11.2016 “Për Procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesë”, Ligji Nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” neni 34, VKB Nr 52 datë 26.12.2023 Për miratimin e programit Buxhetor afatmesëm 2024 – 2026 dhe detajimin e buxhetit për Vitin 2024.

VENDOSI :

Me 12 vota PRO, dhe 1 kundër nga 13 Këshilltarë prezentë:

1. Të miratohet raporti i vlerësimeve për vitet 2021-2023 dhe parashikimeve afatmesme të të ardhurave për tre vitet e ardhshme buxhetore 2024-2026 sipas tabelës bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ngarkohet Sekretari i Këshillit Bashkiak të publikojë vendimin në faqen zyrtare të Këshillit Bashkiak Dimal.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes, sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të Ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

AVDULLA SALILLARI

